

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM


Për Programin e studimit Master Profesional në “Terapi Manuale”

Universiteti Privat “Albanian University”

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha

Dr. Enkeleda Sinaj

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the names. The top signature is for Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha, and the bottom signature is for Dr. Enkeleda Sinaj.


(Qershor/2019)

Faqe 1

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në “Terapi Manuale”

	Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër të MASR Nr. 671 datë 12.10.2018
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Terapi Manuale”
5	Cikli i studimit:	I Dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2018-2019
16	Numri i studentëve	17 studentë



HYRJJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në “Terapi Manuale”

Programi i Studimit **Master Profesional në “Terapi Manuale”**, në Universitetin “Albanian University” është hapur si program i ciklit të dytë të studimit, me miratimin e Komisionit për Kurrikulat e Mësimin të AU, me Vendim të Senatit Akademik dhe licensuar me Urdhër të MASR Nr 671 datë 12/10/2018.

Ky program realizohet nga Departamenti i Infermierisë e Fiziotherapisë, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në një vit, me kohë të plotë, gjithësej 60 ECTS.

Programi i studimit iu drejtohet kandidatëve që zotërojnë një Diplomë Bachelor në Fizioterapi. Programi i Studimit ka filluar në vitin akademik 2018-2019, pra është brezi i parë i studentëve që do të diplomohen në këtë fushë. Ky program studimi është projektuar për të ofruar një formim më të specializuar me teknikat bazë të terapisë manuale, me qëllim inicimin e përgatitjes së specialistëve që do të operojnë në këtë disiplinë shkencore.

Programi ka karakter formimi të thelluar teorik e praktik profesional, mbi bazën e njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara gjatë studimeve në programin Bachelor Fizioterapi

Synohet në formimin e bazës kulturore për procesin e aplikimit të profesionit në dimensione tekniko - shkencore, ligjore dhe deontologjike, që rregullojnë aktivitetin e lirë profesional, organizatat shëndetësore dhe përgjegjësitë profesionale.

Synohet, që nëpërmjet Programit të MP në Terapi Manuale të fitohen aftësi për tu përballur me problematika të ndryshme të lidhura me rehabilitimin, planifikimin, organizmin, integrimi në punën në ekip e bashkëpunimin me figurat e tjera profesionale të përfshira në proceset e fiziotherapise e rehabilitimit.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha dhe Dr. Enkeleda Sinaj si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistet e ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 05.06.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Në datë 10.06.2018 Institucioni kthen përgjigje në formë zyrtare me shkresë Nr. 346 prot., datë 10.06.2019 në lidhje me Draft – RVJ, në të cilën sprehet se **nuk ka komentet** në lidhje me të.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit MP në Terapi Manuale, ka karakter formimi më specifik teorik e praktik profesional, mbi bazën e njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara gjatë studimeve në programin Bachelor në Fizioterapi.

Synohet në formimin e bazës kulturore për procesin e aplikimit të profesionit në dimensione tekniko - shkencore, ligjore dhe deontologjike, që rregullojnë aktivitetin e lirë profesional, organizatat shëndetësore dhe përgjegjësitë profesionale.

Synohet si objektivi final, që nëpërmjet programit të MP në Terapi Manuale të fitohen aftësi për tu përballur me problematika të ndryshme të lidhura me rehabilitimin, planifikimin, organizmin, integrimi në punën në ekip e bashkëpunimin me figurat e tjera profesionale të përfshira në proceset e fizioterapise e rehabilitimit.

Objektivat e vendosura i përgjigjen më së miri misionit, që ka marrë përsipër Universiteti dhe realizohen në bazë të një strategjie të përcaktuar nga organet drejtuese të njësisë. Programi i studimit MP në Terapi Manuale synon që studentët të pajisen me bazat shkencore teorike e praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit në praktikën e përditëshme klinike. Përgatitjen e profesionistëve të aftë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe etike në sektorin e reabilitimit, në përputhje me standardet bashkëkohore.

Programi i studimit është projektuar dhe zhvilluar për të përmbushur nevojat e tregut shqiptar me figura profesionale të afta për të punuar në sistemin shëndetësorë shqiptar dhe për ta menaxhuar atë, në gjendje për tu përballur me realitetin tonë dhe për ta përmirësuar atë. Në këtë kuadër, programi është hartuar dhe në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Universitetit, duke kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë shqiptar, me një arsimim cilësor universitar dhe pasuniversitar në fusha të ndryshme profesionale, edukimin me vlerat më të mira morale dhe zhvillimin e kërkimit shkencor, duke siguruar në këtë mënyrë praninë e specialistëve të aftë profesionalisht dhe të pastër moralisht në gjendje për të çuar përpara procesin e zhvillimit të sistemit shëndetësorë e shoqëror në Shqipëri.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Duke analizuar misionin dhe qëllimin e institucionit, shprehur edhe në rregullore, marrëveshje dhe objektiva të dokumentuara del qartë, që Programi Master Profesional në "Terapi Manuale" është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka ky Universitet, për të dhënë

<p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë, edukimin e vlerave më të mira morale, zhvillimin e kërkimit shkencor, formimin cilësor profesional të specialistëve të lartë shkencore, pasqyrë e të cilave do të jenë të diplomuarit në fushën e fizioterapisë</p> <p>Nga takimet me drejtues të Universitetit, stafin pranë universitetit, dhe studentët që tashmë kishin mbaruar programin Bachelor në Fizioterapi dhe vazhdonin Master në Terapi Manuale, pyetur mbi kërkesat dhe punësimin e kolegëve të tyre, u informuam që; njohuritë dhe aftësitë e tyre, fituar nga programet e studimit ishin në përputhje me ato çka kërkoheshin në vendet e punës, ku ata punonin, madje jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e tjera të Europës.</p> <p>Kishte studentë që ndiqnin programin e Masterit të cilët ishin punësuar qysh tani në institucione, ku ofrohet shërbimi i fizioterapisë dhe rehabilitimit.</p> <p>Programi Profesional në "Terapi Manuale" hapet dhe është hartuar për t'iu përshtatur e përgjigjur zhvillimit ekonomik të vendit. Sipas dokumentacionit të Institucionit, hartimi i tij u nxit nga një nevojë tashmë e shoqërisë në kushtet e reja kur krahas sektorit publik shëndetësor kemi edhe atë privat qoftë ky spitalor apo ambulator, e deri tek qendrat estetike, ku kërkohen metoda e mjete bashkëkohore menaxhuese, reabilituese e rekuperuese nga individë e grupe të caktuara në nevojë për fiziomasokinesiterapi e reabilitim.</p> <p>Nëpërmjet programit të studimit që ofrohet synohet të ruhen vlerat kulturore kombëtare siç janë gjuha, historia, simbolet kombëtare, traditat dhe të përgatiten profesionistë të ardhshëm që do të mbartin këto vlera</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit Master Profesional në "Terapi Manuale" është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar</p>

përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Në hartimin e tij janë marrë parasysh Ligji i Arsimit të Lartë, Udhëzimet e ndryshme të MASR që lidhen me programet e studimit si numri i krediteve (ECTS), tipologjia e lëndëve dhe moduleve, detyrimi i realizimit në fund i temës së diplomës, formati I diplomës e suplementi, etj.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	Referuar dokumentit të Strategjisë së AU 2017-2022, Institucioni ka një Plan Strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve dhe për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Ky Plan gjendet i mbështetur mbi objektiva profesionale, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe synimin për zhvillimin e këtij profesioni.
Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Në strategjinë e institucionit janë të përcaktuara objektivat për stafin, infrastrukturën dhe studentët duke patur në fokus kryesor përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
Programi i studimeve është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; me nevojat e tregut të punës; me zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit; me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; dhe mbi bazen e një strategjie të studuar e të përditësuar që synon garantimin e cilësisë së mësimdhënies e të nxënit.	

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

AU e organizon aktivitetin akademik mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës duke u organizuar në tre fakultete si më poshtë:

- a. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
- b. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
- c. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Fakulteti i Shkencave Mjekësore është organizuar si më poshtë:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
- Departamenti I Stomatologjisë
- Departamenti I Farmacise

Është zbatuar kërkesa ligjore për të patur cdo department jo me pak se 7 anëtarë dhe raporti I atyre me grada shkencore e tituj akademikë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)

Në rang IAL organizimi i AU ishte si më poshtë:

Rektori është funksionari drejtues akademik më i lartë. Ai përfaqëson me të tretët Universitetin duke vepruar në emër dhe për llogari të tij. Rektori përfaqëson Universitetin në marrëdhëniet me Ministrinë e linjës dhe institucione të tjera të administratës publike, në marrëdhëniet me jashtë dhe me institucione të tjera homologe. Rektori drejton Këshillin e Etikës dhe miraton ose prapëson me urdhra të veçantë çdo propozim që i paraqitet lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës në Universitet.

Administratori është autoriteti më i lartë drejtues administrativ i Universitetit. Administratori drejton Bordin administrativ, duke gëzuar të drejtën e vetos.

Rregullat dhe kompetencat e tij parashikohen në Statutin e Universitetit, në këtë Rregullore dhe në Rregulloret e tjera të veçanta.

Këshilli i profesorëve është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë Universitetit nga Senati akademik për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës. Këshilli i Profesorëve siguron një marrëdhënie të ngushte me Njësitë bazë të Universitetit lidhur me kriteret dhe vlerësimin e kandidatave të studentëve që aplikojnë për programet e ciklit të tretë akademik sipas kriterëve përkatëse.

Këshilli i Fakultetit është organ drejtues kolegjal vendimmarrës i cili drejtohet nga Dekani.

Këshilli i fakultetit përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe studentë. Mandati i Këshillit të Fakultetit është 4 vjeçar.

Mënyra e funksionimit, përbërja dhe çështje të tjera organizative dhe vendimmarrëse përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Dekani është funksionari më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Dekani emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Administratori i Universitetit me propozimin e Senatit akademik për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi. Dekani duhet të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose gradën shkencore 'Doktor' të fituar pranë universiteteve perëndimore.

Kompetencat e Dekanit, marrëdhënia e tij me strukturat e tjera në nivel Fakulteti parashikohen në Rregulloren e Fakultetit.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet. Ai ka për detyrë të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Qendra Kërkimore - Shkencore (QKSh) është njësi bazë me strukturë të ngjashme dhe të barazvlefshme me departamentin, fusha e kërkimit të së cilës harmonizohet me interesa të departamenteve të fakultetit.

Qendrat bashkërendojnë planin e punës shkencore me departamentet e fakultetit, kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë.

Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me njësitë bazë, përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Përgjegjësi i departamentit në Fakultet është funksionari më i lartë drejtues i njësisë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton dekanit. Përgjegjësi i departamentit propozohet nga Senati akademik dhe emërohet nga Administratori me një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Te dhënat janë paraqitur në anekse. Është bërë edhe përditësim me të dhënat që marrëm direkt në vend në momentin e vlerësimit të jashtëm

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (plotëso Tabelat ne aneks) Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë aktualisht janë pjesë përbërëse e tij 52 personel akademik efektivë nga të cilët 4 Prof, 2 Prof Asc, 10 Dr, etj Msc, departamenti e përmbush kriterin ligjor për personelin akademik të departamentit.

Personelit Akademik me Kontratë (PAK), gjithësej 43 nga të cilët 13 te kategorisë Prof, 14 Dr, pjesa tjetër Msc.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion por edhe gjatë shqyrtimit të RVB, GVJ konstaton se AU e organizon aktivitetin akademik mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës duke u organizuar në tre fakultete si më poshtë:</p> <p>a. Fakulteti i Shkencave Mjekësore b. Fakulteti i Shkencave Shoqërore c. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore është organizuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë • Departamenti I Stomatologjisë • Departamenti I Farmacisë <p>Në Departamentin përgjegjës për këtë program studimi, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë aktualisht janë pjesë përbërëse e tij 52 personel akademik më nga të cilët 4 Prof, 2 Prof Asc, 10 Dr, etj Msc, departamenti e përmbush kriterin ligjor për personelin akademik të departamentit.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Gjatë takimeve që realizoi GVJ, Drejtuesit e këtij Institucioni theksuan se Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tyre për realizimin sa më cilësor të programit të studimit. Kjo përgjegjësi dukej në hartimin e programit të studimit konform akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore përpiqej që të rekrutonte staf mësimdhënës me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme me tituj dhe me grada, <i>por u evidentua vështirësia në rekrutimin e këtij stafi për</i></p>

arsye të mungesës së pedagogëve me tituj kryesisht në fushën e fizioterapisë e rehabilitimit e për më tepër në terapi manuale në nivel kombëtar. Gjatë takimit me Drejtuesin e Fakultetit na u komunikua se Dekanati në bashkëpunim me departamentin përcaktojnë kriteret specifike për pozicionin e punës duke vlerësuar përgatitjen profesionale dhe ngritjen akademike të kandidatave. Ka pra një procedurë të përcaktuar për çdo hap në drejtim të rekrutimit të stafit akademik. Rekrutimi i stafit është transparent, kriteret propozohen nga departamenti në varësi të nevojës që kanë për staf. Kriteret bëhen publike në faqen e internetit të AU. Cdo aplikant në kalon nëpër dy procese vlerësimi, që janë vlerësimi në baza dokumentacioni dhe vlerësimi nga komisioni që është ngritur për këtë proces.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni është i organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin e tij.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore është i përbërë nga 3 departamente, Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, funksionojnë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, përpiqen që të rekrutojnë staf mësimdhënës me tituj dhe me grada, por u evidentua vështirësia në rekrutimin e stafit specifikisht për këtë program, për arsye të mungesës së pedagogëve me tituj kryesisht në fushën e fizioterapisë e rehabilitimit e për më tepër në terapi manuale në nivel kombëtar.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Sipas drejtuesve të Institucionit, AU ka synuar të rekrutojë staf të kualifikuar me përvojë akademike dhe profesionale. Në programin e Terapisë Manuale është synuar gjatë kësaj periudhe që ofrohet ky program, përzgjedhja e stafit akademik efektiv qysh në përgatitjen e kurrikulës, si një domosdoshmëri për specifikën e këtij programi. Gjithashtu ka lindur edhe si detyrim për të rritur cilësinë dhe standardet e mësimdhënies.

Për këtë program, ishin ofruar kandidatë që kanë përvojë në fushën pedagogjike si dhe përvojë në ushtrimin praktik të profesionit. Përveç pedagogëve me tituj e grada, për lëndet e karakterit të përgjithshëm formues, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore janë punësuar edhe pedagogë me Master shkencor apo Specializime



afatgjatë, por që kanë një eksperiencë specifike e të suksesshme në profesionin e fizioterapeutit e rehabilituesit. Disa prej këtyre pedagogëve kanë mbaruar studimet ose janë specializuar jashtë vendit.

Ngarkesa e stafit akademik të angazhuar në këtë program ndodhet në system. Pedagogët me kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënien e programit MP për vitin akademik 2018-2019 rezultojnë në total me një numër lëndësh në përputhje me aktet ligjore të arsimit të lartë, që nuk lejon mbi 3 lëndë.

Në rekrutimin e stafit akademik zbatohet praktika sipas kriterëve të rekrutimit, të miratuara në Senatin akademik. Departamenti përfshihej në procesin e rekrutimit të stafit akademik i cili bëhet në disa faza si më poshtë: Parashtrohet kërkesa në përputhje me vendet e lira si dhe me ngarkesën mësimore duke hartuar kriteret specifike për këto vende. Dekanati pasi merr me shkrim kriteret nga departamenti i kërkon Rektorit aprovimin për fillimin e procesit, kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit. Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet 3 muaj provës për të vendosur a do të vazhdojë apo do të ndërpritet rekrutimi i tij. Marrëdhëniet rregullohen me kontratë pune mbështetur në Kodin e Punës dhe legjislacionit për Arsimin e Lartë në vendin tone.

Gjatë vitit akademik 2018-2019 njësisia bazë me vendim senati duke parë nevojat hapi procedura rekrutimi edhe para fillimit të semestrit të dytë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela në aneks)

Theksojmë se ky është një program i ri studimi, i cili është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019. Aktualisht në këtë program studimi janë të angazhuar 18 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 8 PAK.

Stafi akademik PAE ka kualifikimin si vijon: 1 Prof. Dr dhe 9 Msc.

Stafi akademik PAE ka kualifikimin si vijon: 4 Prof. As, 1 Dr. Dhe 3 Msc.

Ngarkesa mësimore e stafit akademik është e përcaktuar nga Departamenti në bazë të nevojave që ka ai. Në AU për shpërndarjen e ngarkesës mbahen parasysh aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe vendimet e Senatit Akademik të IAL. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një ngarkesë që në nr. lëndësh që varion nga 1 deri në tre lëndë dhe 30 deri në 180 orë. Kjo ngarkesë e ulët i lëjon stafit akademik që të merret edhe me punë kërkimore, edhe pse ajo që vihet re është se stafi akademik është i përfshir në nivele minimale në kërkim shkencor.

Vlen të theksojmë se stafi rreth 66% e stafit akademik (PAE dhe PAK) nuk kanë grada dhe tituj akademik, ata janë Msc, por të gjithë kanë një eksperiencë mbi 5 vjetecare në arsimin e lartë. Institucion bën përpjekje të vazhdueshme për rekrutim e stafin akademik me tituj dhe grada, por duke qënë se terapia manuale është një fushë relativisht e re, kjo e bën edhe më të vështirë rekrutimin e stafit me tituj dhe grada.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat në aneks)

Stafi akademik për programin e studimit Master Profesional në "Terapi Manuale" Viti akademik 2018-2019, përbëhet nga 18 pedagogë, nga të cilët 10 janë PAE dhe 8 PAK.

Kualifikimi i tyre është : Stafi akademik PAE janë të angazhaur 1 Prof. Dr dhe 9 Msc dhe stafi akademik PAE janë të angazhaur 4 Prof. As, 1 Dr. Dhe 3 Msc.

Duke iu referuar planeve mësimore të programit të studimit të lidhura me personelin akademik përkatës kualifikimi i tyre dhe fusha e ekspertizës përputhet me lëndët që mbulojnë, nga ana tjetër ngarkesa e tyre është përcaktuar konform ligjeve e udhëzimeve në fuqi si nga numri I lëndëve që japin (jo më shumë se tre) edhe për ngarkesën apo llojin e mësimdhënies leksion apo seminar, laboratorë, praktikë.

Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat në aneks)

Stafi akademik për programin e studimit Master Profesional në "Terapi Manuale" Viti akademik 2018-2019 ka raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 10/8.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga zyra e burimeve njerëzore na u sqarua se si lidhet kontrata e punës me personelin akademik por edhe atë administrative, sipas nevojave që kishte Institucioni, Pas procesit të rekrutimit, personeli akademik e administrativ lidhte kontratë pune me Universitetin hartuar kjo në bazë të ligjit të "Kodit të Punës", e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, të cilat përshkruhen edhe në rregulloret dhe Statutin e Institucionit.

Kontratat e punës në Universitet janë ndarë në tre lloje: staf akademik me kohë të plotë, staf akademik me kohë të pjesshme dhe staf administrative dhe ndihmës. Ato janë miratuar nga Senati dhe përmbajnë përshkrimin e punës, pagën si dhe të drejtat dhe detyrimet që lindin prej saj. Me një përzgjedhje rastësore, GVJ kontrollon dy kontrata pune (1 për personal me kohë të plotë dhe 1 për personel me kohë të pjesshme).

Kontratat e punës për personelin me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, ishin lidhur konform kriterëve e ligjeve që përmendëm më sipër.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë (Plotëso Tabelat në aneks)

U konstatua një angazhim i kënaqshëm i personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve teorike, laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve ku beheshin leksionet, praktikat e në vecanti për Mjediset e Fizioterapisë e Rehabilitimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-	GVJ gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore por

<p>shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>edhe gjatë vizitës në ambjentet e AU ku zhvillohej mësim, konstatoi një angazhim të kënaqshëm të personelit akademik, administrativ dhe atij ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve teorike, laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve ku bëheshin leksionet, praktikat lëndore e në vecanti për Mjediset dhe laboratorët në funksion të programit të Terapisë Manuale.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë takimit me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve. Titullarët e lëndëve përgatisin syllabuset për çdo lëndë. Ato përmbajnë të gjithë elementet e duhura si nga përmbajtja (tematika) edhe objektivat, mënyrën e realizimit dhe vlersimin e studentëve, literaturën etj.</p> <p><i>Vërejmë se disa titullarë të lëndëve nuk janë personel akademik me kohë të plotë</i> pranë këtij Institucioni. Çdo vendim institucional për përmirësime apo ndryshime në kurrikula, merrej duke u bazuar në propozimet e bëra nga njësitë bazë. Institucioni ka përcaktuar qartësisht kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e stafit akademik.</p> <p>Rekrutimi i personelit në AU bëhet në bazë të kriterëve të përgjithëshme të hartuara nga Dekanati dhe ato specifike të hartuara nga Departamenti. Edhe ngarkesa mësimore hartohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, për të plotësuar nevojat e programeve të studimit për staf akademik, ndihmës shkencor dhe administrativ ndjek politikën e punësimit dhe të rekrutimit të stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme sipas nevojës. Ka procedurë të caktuar për punësimin e personelit akademik që kalon në disa hallka si statuti, rregulloret etj.</p> <p>PAE është i angazhuar në realizimin e programit Terapi Manuale në masën mbi 78% si të orëve edhe të raportit si numër me PAK (këta të fundit PAK mbulojnë 145 orë mësimore ose rreth 22% të ngarkesës) pra është në përputhje me standardin e kërkuar.</p> <p>Qysh në rekrutim institucioni është transparent, informon hap pas hapi mbi mundësinë e punësimit, detyrat dhe të drejtat e stafit akademik parashikuar</p>

	<p>këto edhe në statut, rregullore, etj, të AU.</p> <p>Vlerësimi është mbështetur në faktorë si mësimdhënia, dhënia e asistencës dhe konsultimeve me studentët, kërkimi shkencor, pjesëmarrja në seminare, konferenca, kongrese workshope, botimet shkencore, respektimi i konfidencialitetit në lidhje me aktet e institucionit, shfrytëzimi me efikasitet i kohës së punës, veprimtari mbështetëse për institucionin gjatë vitit akademik.</p> <p>Fakulteti në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore mban rekordet e procesit të rekrutimit dhe të dhënave të kandidatëve aplikues si dhe shpalljen e fituesve dhe ka krijuar një bazë të dhënash në vite. Ato ruhen në format elektronik dhe hardcopy pranë Zyrës së burimeve njerëzore.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit MP në Terapi Manuale është me Gradë Shkencore PhD mbrojtur jashtë në vendet perendimore (Itali) dhe është njëkohësisht edhe përgjegjës departamenti.</p> <p>Titullarët (koordinatorët) e grup-lëndëve mbajnë gradën/titullin Doktor dhe Prof Asc.</p> <p>Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” në Terapi Manuale ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi; Rekrutimi i atyre me Msc me përvojë është i lidhur me mungesën në vendin tone të Dr Shkencash të mirëfilltë të fushës fizioterapi, rehabilitim e aq më tepër terapi manual.</p> <p>Drejtuesit e AU, ata të Njësisë Kryesore por edhe drejtuesit e njësisve bazë të Fakultetit ku ofrohej ky program studimi janë punësuar me kohë të plotë, cka parashikohet edhe në Statutin e Universitetit.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se Institucioni kishte krijuar mundësinë dhe siguronte personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale duke iu ofruar studentëve gjithcka ata kishin nevojë.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit MP në Terapi Manuale, përcakton që studentët mund të diplomohen me anë të provimit përfundimtar të formimit ose edhe me punim diplome.</p> <p>Në rastin e dytë janë marre masat të ketë udhëheqës të punimit diplomës dhe këta të jenë me tituj e grada shkencore.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit kanë graden/titullin dhe formimin në fushën e lëndës që japin dhe ku mund të ofrohet usdheheqje për punën e diplomës.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>U konstatua një angazhim optimal i personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve, në veçanti për mjediset e Fizioterapisë Rehabilitimitit e, për kabinetet e përdorura për këtë program. GVJ gjatë vizitës në laboratorët në funksion të këtij programi vuri re, qe laboratorit I praktikës edhe si kubaturë edhe pajisje ishte ai I programit të fizioterapisë, numri pakët I shtretërve kërkon angazhim të mëtjshëm për investim të këtij Institucioni për një mbarëvajtje në realizimin e kurikulës Terapi Manuale krahas programeve të tjera që përdorin këtë laborator.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>GVJ konstatoi se drejtuesi i njësisë bazë në koordinim me secilin pjestar të stafit, në çdo fillim viti akademik përcakton ngarkesën mësimore të secilit. Ngarkesa mësimore brënda auditorit vlerësohej në orë mësimore. Ajo ishte planifikuar e realizuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, si për PAE dhe PAK.</p> <p>Stafi akademik i angazhaur në këtë program studimi ka një ngarkesë që në nr. lëndësh që varion nga 1 deri në tre lëndë dhe 30 deri në 180 orë. Ngarkesa e antareve të stafit është e tillë qe ti lejojë ata të merren edhe me punë të tjera në ndihmë të institucionit apo me punë kërkimore-shkencore. Kjo u pohua edhe gjatë takimit të GVJ me stafin e këtij programi.</p>

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit:

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

GVJ gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore konstatoi se të dhënat për personelin janë të arkivuara pranë kësaj zyre dhe përditësohen gjatë vitit akademik. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës shkencor dhe administrativ, si dhe dokumentacionin e nevojshëm të cdo punonjësi.

Të dhënat e personelit hidheshin dhe ruheshin në sistemin informatik që është instaluar për burimet njerëzore pranë institucionit dhe hardcopy.

Në çdo departament janë të përcaktuara kriteret e rekrutimit të personelit sipas nevojave të institucionit dhe ato parashtrihen në përputhje me ngarkesën mësimore specifike për vendet vakante. Rektorati e Senati ka të përcaktuar një procedurë për rekrutimin e stafit akademik

Konkluzionet e vlerësimit:

Struktura për departamentet ose programin e studimit është optimale e sipas standardeve. Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, plotësojnë nevojat e realizimit të programit,

Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit është në përputhje me kërkesat e vendosuar nga Institucioni.

Në stafin mësimdhënës paraqiten edhe lektorë me titull Msc, që kanë përvojë dhe eksperiencë disa vjetecare dhe që kanë mbaruar studimet Master ose kualifikime në vendet e BE-së, gjë që nuk e çënon realizimin me cilësi të programit të studimit. Realiteti është që në tregun shqiptar mungojnë pedagogë me titull dhe grada pasi programet e Fizioterapisë, Rehabilitimit e për më tepër Terapisë Manuale sepse janë programe relativisht të reja.

PAE i angazhuar në realizimin e programit Terapi Manuale mbulon në masën mbi 78% si të orëve edhe të raportit si numër me PAK, këta të fundit PAK mbulojnë 145 orë mësimore ose rreth 22% të ngarkesës.

Tashmë është krijuar një bazë të dhënash elektronike të dokumentacionit për cdo pjesëtar të stafit akademik, si CV, aktivitet shkencor, kualifikime etj.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në shërbim të programit të studimit MP Terapi Manuale, por edhe të disa programeve të tjera të ofruara nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, është vënë në dispozicion një ndërtesë e madhe, e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj, e përshtatshme për studentët me klasa dhe laboratorë për secilin nga programet e studimit. Universiteti dispononte klasa me hapësira të kënaqshme, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike.

Labororet e Universitetit ishin të pajisura dhe të mjaftueshme për momentin për të realizuar praktika mësimore (kemi këtu parasysh edhe shfrytëzimin e ambjenteve të institucioneve që kanë lidhur marrveshje me AU). Ka shtretër profesional për manipulime, mjete të tjera ndihmëse për T Manuale e rehabilitim fizioterapeutik.

Megjithatë numri i shtretërve është i vogël dhe mund të përballojë numrin e vogël të studentëve për këte vit. ***Por në të ardhmen një numër më i madh studentësh kërkon shtim të shtretërve dhe mundësisht profesionale për terapi manuale (elektrik).***

GVJ I vizitoi të gjitha laboratorët gjatë vizitës dy ditore të tij në këtë institucion.

Në fondin e bibliotekës për Fakultetin e Shkencave Mjekësore numërohen rreth 145 tituj librash me 845 kopje, që u përkasin titujve të ndryshëm specifikë për programet e studimit që ofron ky fakultet.

Por përsa i përket teksteve profesionale të Fizioterapisë, Rehabilitimit e Terapisë Manuale janë të pakta dhe ka vetëm 5 të tillë, nga të cilët 3 janë traktate të përgatitur nga vetë institucioni nëpërmjet pedagogëve. Risi është përkthimi i dy traktateve të këtyre fushave dhe kërkesa e financimi për më tej nga fondi i librave ofruar nga "Elsevier"

Biblioteka on line është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare të këtij Institucioni. Gjatë vizitës në vend, kërkua të na shpjegohej se si funksiononte kjo bibliotekë. Mund të përmendim një sërë librarish on line si: Cambridge Journals, www.cambridge.org/core; "Questia", www.questia.com; "Elsevier", www.textbooks.elsevier.com.

Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore punonte me orar të zgjatur, nga ora 08⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj. Studentët e këtij programi edhe pse së shumti angazhoheshin në procesin mësimor pas dite, mund të shfrytëzonin paraditen për bibliotekën. Për çdo student kishte kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës, si dhe sistem të kompjuterizuar të shërbimit bibliotekar. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar. Kjo detyrë dhe programi i menaxhimit të saj është hartuar nga vetë studentët e institucionit, si pjesë e detyrave të kursit dhe e prezantimeve të tyre në konferenca shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyre informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore




- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti “Albanian University” prej shumë vitesh është pozicionuar në 3 ambjente në qendrën të Tiranës. Departamenti I Infermierisë e Fizioterapisë zhvillon programet në ndërtesën e ish Gjykatës, Rr. Durrësit.</p> <p>Këto mjedise janë në dispozicion të Universitetit e Fakultetit qysh prej 10 vjetësh.</p> <p>Kur lind nevoja për lëvizje ne godinat e tjera, ato janë lehtësisht të arritshme nga studentet ne këmbe ne harkun kohor prej 5 minutash.</p> <p>Godina ku zhvillohet mësimi është një godinë relativisht e re, me sipërfaqe të bollshme, me auditorë e laboratorë për praktikat mësimore, të pajisur me material, teknologji dhe pajisje për realizimin e këtij programi studimi. Po kështu edhe bashkëpunimet jashtë institucionit e mundësojnë cilësinë e realizimit të programit.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore në formë cikël leksionesh cilësore përgatitur nga pedagoget dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj. Në fondin e bibliotekës për Fakultetin e Shkencave Mjekësore numërohen rreth 145 tituj librash me 845 kopje,</p> <p>Por përsa i përket teksteve profesionale të Fizioterapisë, Rehabilitimit e Terapisë Manuale janë të pakta dhe ka vetëm 5 të tillë, nga të cilët 3 janë traktate të përgatitur nga vetë institucioni nëpërmjet pedagogëve. Risi është përkthimi i dy traktateve të këtyre fushave dhe kërkesa e financimi për më tej nga fondi i librave ofruar nga “Elsevier”.</p> <p>Biblioteka online është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare të këtij Institucioni. Gjatë vizitës në vend, kërkua të na shpjegohej se si funksiononte kjo bibliotekë. Më sipër përmendëm edhe një sërë librarish online. Sistemi wireless lehtëson shfrytëzimin e literaturës se vendit apo të huaj nga studentët.</p>

<p>me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Ka plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim; Shembull që do vazhdojë janë titujt e Elsevier përkthyer në shërbim specifikisht për fizioterapinë, rehabilitimin e Terapinë Manuale.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore punonte me orar të zgjatur, nga ora 08⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Albanian University ka vënë në dispozicion të procesit mësimor: laboratorë, klasa, zyra, auditore e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Të gjitha laboratorët janë të pajisura me teknologji, aparatura, video-projektor dhe të gjitha mjetet e tjera specifike për realizimin e programit të T Manuale.</p> <p>Janë disa laboratorë kryesorë që shërbejnë për të kryer orët laboratorike të lëndëve parashikuar ne program. Studentët praktikojnë metodat e Terapi Manuale në me njëri- tjetrit në grupe të vogla 2-3 vetë.</p> <p>Ka shtretër profesional për manipulime, mjete të tjera ndihmese per T Manuale e rehabilitim fizioterapeutik.</p> <p>Megjithatë numri I shtretërve është I vogël dhe mund të përballojë numrin e vogël të studentëve për këte vit. Por në të ardhmen një numër më I madh studentësh kërkon shtim të shtretërve dhe mundësisht profesionale për terapi manual (elektrik).</p> <p>Laboratorët si numër e plotësojnë standardin e nevojshëm për plotësimin e kërkesave të programit të studimit për zhvillimin e lëndëve që në programin e tyre parashikojnë orë laboratorike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera janë optimale në standardet e duhura dhe gjithënjë në përmirësim e sipër. Por në të ardhmen një numër më I madh studentësh kërkon shtim të shtretërve dhe mundësisht profesionale për terapi manual (elektrik)</p> <p>Biblioteka Në fondin e bibliotekës për Fakultetin e Shkencave Mjekësore numërohen rreth 145 tituj librash me 845 kopje, Biblioteka online është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare të këtij Institucioni. Risi është përkthimi i dy traktateve të këtyre fushave dhe kërkesa e financimi për më tej nga fondi i librave ofruar nga “Elsevier”.</p> <p>Laboratorët Janë disa laboratorë kryesorë që shërbejnë për të kryer orët laboratorike të lëndëve parashikuar ne program. Ka shtretër profesional për manipulime, mjete të tjera ndihmese pwr T Manuale e rehabilitim</p>	



fizioterapeutik.

Megjithatë numri i shtretërve është i vogël dhe mund të përballojë numrin e vogël të studentëve për këtë vit.

Rekomandohet që në të ardhmen me shtimin e numrit të studentëve të shtohet numri i shtretërve dhe mundësisht profesionale për terapi manual (elektrik)

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Albanian University është një institucion privat i arsimit të lartë i cili financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Burimi i financimit të UAL janë tarifatat e studentëve. Këto tarifa janë konkurruese në treg. Ka ecuri të qëndrueshme të UAL në të gjitha drejtimet përfshirë atë ekonomik e financiar gjë që flet për mirëmenaxhim nga autoritetet drejtuese. Sipas drejtuesve të UAL, qëllimi kryesor i përdorimit të fondeve në këto vite ka qenë:

- Sigurimi i infrastruktures cilësore në dispozicion të studentëve si laboratore, auditore, biblioteka etj
- Shtimi i numrit të stafit akademik dhe sidomos atyre me tituj/grada shkencore dhe që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Shtimi i titujve të rinj në bibliotekë, abonimi në bibliotekën online, shtimi i numrit të PC, video-projektorëve, informatizimi, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Të ardhurat nga ky program janë 3.162.000. Tarifa studimi. Dhe në programin Terapi Manuale kosto për student 162.688.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtuesit e Institucionit u vu në dijeni se: Institucioni kryen auditim vjetor të brendshëm e jashtëm të situatës financiare dhe garanton vërtetësinë e informacionit financiar</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë dhe Bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit. Auditimi verifikon paraqitjen, regjistrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave, sipas zërave në pasqyrat financiare.</p> <p>Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton raporte financiare të hollësishme të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; Institucioni dokumenton raportet financiare për vitet e kaluara akademike, sic edhe parashikohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe i përshkruan edhe në RVB. Të ardhurat nga ky program janë 3.162.000. Tarifa studimi. Dhe në programin Terapi Manuale kosto për student 162.688.</p> <p>Institucioni ka aftësi menaxhuese dhe dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e shërbimit dhënies, si dhe rritjes së numrit të përfituesve të shërbimit në të ardhmen.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare janë serioze dhe sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. I vetmi burim i financimit janë të ardhurat nga pagesat e studentëve</p> <p>Ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete për rritje të mëtejshme.</p>	




6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur me Vendim të Senatit Akademik nr. 178 dt.23/07/2010 dhe në përputhje me ligjin 80/15 me Vendim të Senatit Akademik nr. 4 dt.22/12/2016 u ngrit Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin Institucional për të siguruar Standardet Shtetërore të Cilësisë e që shprehet edhe në statutin e Universitetit.

Universiteti, nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së aktivitetit akademik, duke bashkëpunuar me (ASCAL) në përputhje me dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri. (NJSBC) është përgjegjëse për proceset e akreditimit, rankimit dhe çdo procedurë tjetër të vlerësimit të zhvillimit të aktivitetit akademik të Universitetit.

Kryerja e vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit bëhet çdo 3 vjet akademikë.

Përfaqësuesit e kësaj njësie bënë një prezantim të shkurtër duke përmendur si funksionon kjo njësi, cilat janë detyrat e saj, si bëhej shpërndarja e punëve brenda saj, etj.

Pra NJSBC funksiononte prej disa vitesh. Kjo njësi kishte si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve mësimore, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimdhënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që ofron. Ekzistenca e kësaj strukturë është e paraqitur në Statut, Rregulloren e Brendshme të Universitetit, Rregulloren e NJSBC.

Gjatë takimit me këtë Njësi, na u komunikua se institucioni dokumenton proceset e vlerësimit të performancës nëpërmjet disa kritereve që vlerësojnë arritjen nga pedagogu të objektivave të lëndës, përbushjen cilësore të pritshmërisë së studentëve, angazhimine pedagogut për përmirësimin e vazhdueshëm të leksioneve, seminareve, praktikave të zhvilluara, veprimtarinë administrative dhe angazhimin e pedagogut në kërkimin shkencor, etj

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Eshtë zhvilluar anketim me studentët e Terapisë Manuale para fillimit të provimeve të semestrit të parë.

Jane anketuar 35% e studentëve.

Nga perpunimi i pyetësorëve del se studentët në përgjithësi shprehen pozitivisht për programin dhe mësimdhënien në përgjithësi.

Zyra synon që të thellojë më tej monitorimin e cilësisë dhe për semestrin e dytë

Të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raporte semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime për përmirsimin e cilësisë.

Kontrulli i brendshëm i cilësisë:

- Realizohet nga NJSBC në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në rang departamenti dhe me Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit institucionit. Metodologjia e përdorur ka qenë, pyetësorë, fokus grupe, raporte vetevlersimi të pedagogëve.
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBC u ka raportuar fakulteteve përkatëse problemet lidhur me rezultatet e pyetësorëve. Pedagogët janë vënë në dijeni të ankesave të studentëve që të marin masa në drejtim të komunikimit profesional dhe etik, si dhe përpërmirësimin e cilësisë së zhvillimit të mësimin për të rritur interesin e formimin e studentëve. Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politikat e përmirësimit të cilësisë përfshihen në strategjitë e zhvillimit institucional, pasi në cdo fund viti NJSBC raporton dhe sugjeron për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e mundshëm të parametrave të cilësisë.

Vlerësimet e jashtëme: në kuadër të vlerësimit nga QAA vlen të theksohet se është vlerësuar praktika e NJSBC se AU për ngritjen dhe bashkëpunimin me grupet e sigurimit cilësisë në rang Departamenti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi L10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	GVJ konstatoi se NJSBC përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese; gjë që realizohet në disa forma. Janë aplikuar si mekanizma të sigurimit të cilësisë ato që kërkohet sot të përdoren nga IAL për ecurinë e programeve të studimeve. Metodologjia e përdorur ka qenë, pyetësorë, fokus grupe, raporte vetevlersimi të pedagogëve. Forma kryesore e vlerësimit të ecurisë së programeve të studimit, zhvillohet nëpërmjet marrjes së vlerësimit të studentëve, nëpërmjet plotësimin nga ana e tyre të pyetësorëve të veçantë për cdo lëndë, ku shprehen për cilësinë e organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, metodologjitë e mësimdhënies, infrastrukturën mësimore e laboratorike, impenjimin e stafit akademik, literaturën e përdorur etj.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.	
Të tërthorta: a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj.	Të dhënat për ecurinë e programit vihen në dispozicion të organeve drejtuese të Universitetit
Të drejtpërdrejta: a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të	

<p>standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Fakultetit, Departamentit dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore duke I ndihmuar për zhvillimin e politikave e strategjive të reja të zhvillimit të institucionit.</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p>Disa nga metodat e përdorura, GVJ vecon:</p> <p>-Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata mund të shprehen në kushte anonimiteti për të gjitha këto procese.</p> <p>-Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore.</p> <p>- Organizon edhe focus grupe, ky studentët pyetën për cilësinë e mësimdhënies, për pedagogët etj.</p> <p>Të gjithë studentët gjatë kryerjes së praktikave të tyre mbikëqyren nga përgjegjësit e caktuar.</p> <p>Një risi ishte se NJSBC kishte realizuar pyetësorin e stafit akademik, me ana të të cilit maste kënaqshmërinë e stafit kundrejt IAL. Gjatë vizitës na u vu në dispozicion edhe raporti që kishte hartuar NJSBC.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Njësia e sigurimit të brendshëm te cilësisë harton çdo vit një raport vjetor për veprimtarinë e saj në institucion. Raporti me pas i kalon Rektorit të Universitetit duke qënë se kjo njësi është nën varësinë e rektoratit. Më tej shkon në Senatit Akdemik dhe bëhet pjesë e raportit vjetor që dërgohet në MASR. Ky raport hidhet në faqen e web-it të AU dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, pedagogët por dhe për publikun.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni harton një raport vjetor të veprimtarisë së tij. Në hartimin e këtij raporti marrin pjesë të gjithë aktorët si stafi pedagogjik, administrativ dhe studentët. Në këtë raport përshkruhet ecuria e institucionit gjatë një viti kupërfshihet edhe ecuria e programeve të ciklit të dytë. Këto vlejën për hartimin e politikave në shëbim të përmirësimit të cilësisë së programit. Ky raport hidhet në faqen e Web-it dhe një kopje dërgohet edhe në MASR.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti "AU" është i akredituar institucionalisht. Me Vendim të Bordit Akreditimit ai është akredituar institucionalisht me vlefshmëri 2 vjet.</p> <p>Sigurimi i Cilësisë në AU realizohet në forma të ndryshme duke përfshirë instrumentet e duhura dhe rolin aktiv të zyrave të ndryshme pjesë të Institucionit.</p> <p>Janë aplikuar mekanizma për një sigurim sa më të mirë të cilësisë.</p> <p>Personeli akademik përfshihej në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e sigurimit të cilësisë, duke u ndërgjegjësuar në rëndësinë e dhënies së kontributeve të drejtpërdrejtë në këtë proces.</p> <p>Institucioni harton politika dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre; kjo bëhet në zbatim të një strategjie për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p> <p>Të gjitha këto pasqyrohen edhe në RVB</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi të cilësisë, ka ndërtuar dhe disponon instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. Ka informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Kryen analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi Master Profesional në "Terapi Manuale" është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka ky Universitet, për të dhënë kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë, ai është planifikuar një vit akademik me 2 semestra me një plan mësimor që I përmban të gjithë elementët e një programi të arësimit të lartë (lëndët/modulet, kreditet, raportet leksion/seminare/praktikë, etj)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Ky program MP në Terapi Manuale është një program i ri në AU dhe fillon për herë të parë për vitin akademik 2018-2019.

Duke analizuar misionin dhe qëllimin e institucionit, shprehur edhe në rregullore, marrëveshje dhe objektiva të dokumentuara del qartë, që Programi Master Profesional në "Terapi Manuale" është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka ky Universitet, për të dhënë kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë, edukimin e vlerave më të mira morale, zhvillimin e kërkimit shkencor, formimin cilësor profesional të specialistëve të lartë shkencore, pasqyrë e të cilave do të jenë të diplomuarit në fushën e terapisë manuale.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka _30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka _15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela në Aneks)

Në planin mësimor të paraqitur është zbatuar raporti ligjor i ngarkesës mësimore në auditor (656.5 orë/vit akademik) dhe pjesa tjetër jashtë auditorit puna e pavarur e studentit gjatë vitit akademik). Të qarta janë edhe raportet e formave të mësimdhënies (Leksione 180 ore, Seminare 97.5 orë, Praktika profesionale 375 orë). Pra pjesa teorike, leksionet zenë 27% të orëve dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale 73% të orëve). Ky raport shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij Program Studimi.

Përqindja e lëndëve A (10%) +B (40%) është 50% dhe përputhet me kërkesat e VKM Nr.41/2018, shtojca Nr.1. Përsa i përket pjeses tjetër të lëndëve C, D, E ato janë përkatësisht në nivelet 30%, 10% dhe 10%. Në këtë program kreditet e lëndëve shprehin rëndësinë që ka praktika profesionale.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Për leksionet	180 orë në auditor dhe	420 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	97.5 orë në auditor dhe	227.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Laboratorët	_____ orë në auditor dhe	_____ orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën lëndore	225 orë në auditor dhe	_____ orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	150 orë në auditor dhe	_____ orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	_____ orë në auditor dhe	150 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën në Aneks)

Nuk ka ndryshime në planimin mësimor pasi është viti i parë i aktivizimit të programit të studimit.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotësoni Tabelën në Aneks)

Duke iu referuar planeve mësimore të programit të studimit të lidhura me personelin akademik përkatës kualifikimi I tyre dhe fusha e ekspertizës përputhet me lëndët që mbulojnë, nga ana tjetër ngarkesa e tyre është përcaktuar konform ligjeve e udhëzimeve në fuqi si nga numri I lëndëve që japin (jo më shumë se tre) edhe për ngarkesën apo llojin e mësimdhënies leksion apo seminar, laboratorë, praktikë.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset në dosjen e vetevlersimit janë të plotë dhe përmbajnë të gjithë elementët përbërë.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Referuar VKM Nr.41/2018, Shtojca Nr.2, syllabuset në dosje janë sjellë pa mungesa në elementët përbërës të mëposhtëm:

Ato i përmbushin të gjitha pikat e Shtojcës nr. 2 të VKM Nr 41/2018.

Vihet re një korrelim i mirë midis titujve të syllabuseve dhe përmbajtjes së tyre, si dhe përputhje e tyre me qëllimin dhe objektivat e programit studimor të propozuar.

Në syllabuse dhe strukturën e stafit pedagogjik shihet mbulim i plotë i lëndëve me pedagogë të jashtëm e të brendshëm, me tituj akademik Doktor, Prof. Asoc, dhe Profesorë.

Metodat e mësimdhënies janë shprehur qartë në çdo syllabus dhe janë në përputhje me specifikat e secilës lëndë.

Referuar “Rregullores së Programit” dhe syllabuseve, për çdo lëndë shprehen qartë format e vlerësimit me përqindje vlerësuese sipas formës, provim i ndërmjetëm, provim final, vlerësime detyrash (detyrime), etj.

Bazuar tek Plani mësimor dhe syllabuset rezultojnë se ky program është strukturuar për të shërbyer studentëve për një formim sa më bashkëkohor, gjë që shihet edhe tek përmbajtja e programeve të lëndëve.

Ka një përputhje të ngarkesës në auditor dhe jashtë tij të studentit, me pritshmëritë e programit. Përmbajtja e programit është e kuptueshme dhe e përballueshme për studentët.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron program studimi MP, të organizuar në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Ky program është I ri në proces akreditimi.</p> <p>Respektohet sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student, që ndjek një program studimi me kohë të plotë dhe është 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë si Master Profesional, në Terapi Manuale i pajis studentët që zotërojnë diplomën “Bachelor” me njohuri më të thelluara, teorike dhe praktike, e trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë si Master Profesional në Terapi Manuale synon të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; dhe aplikimin e këtyre njohurive në praktikën profesionale</p> <p>Programi i studimeve të ciklit të dytë si Master i Profesional, në Terapi Manuale jep mundësinë pas përfundimit të tij si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, si dhe të drejtën të e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Ky program studimi pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Ky program ka objektiva të qartë profesionale dhe është nisur nga nevoja për specialistë të kësaj fushe e konstatuar nëpërmjet takimeve, intervistave apo informacioni i atyre që kane mbaruar studimet bachelor në këtë universitet dhe jane tashme të punësuar.</p> <p>Të diplomuarit mund te punësohen në Spitale publike apo private, qendrore, rajonale e të rretheve. Mund të punësohen në klinika private, palestra fitness-i, sallone të estetikës, qendra sportive etj. Diploma e tyre u lejon atyre edhe karriere ne IAL apo institucione që parashikojne vende pune te ketij profesioni.</p>

arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Sa I takon këtij program MP Terapi Manuale, përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Duke u njohur me vlerësimet e semestrit të parë del se metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare e dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve gjatë studimeve.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit MP në Terapi Manuale mbështetet në përvojën disavejeçare të këtij institucioni në fushën e fizioterapisë e rehabilitimit dhe praktikatat e mira të vendeve europiane me të cilët edhe kanë bashkëpunim;</p> <p>Programi i studimit është ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë, është hartuar e bazohet mbi kriteret e Bolonjës (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to dhe metodatat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Nga të dhënat e studentëve të diplomuar pranë AU në ciklin e parë në Fizioterapi, është konstatuar se, disa prej tyre kanë arritur të punësohen jashtë vendit duke bërë njehsimin e diplomës në shtete të huaja.</p> <p>Programi i studimit MP në Terapi Manuale është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve</p>	<p>Programi i studimit MP në Terapi Manuale përfshin aftësimin profesional dhe elemente të punës shkencore me qëllimin për të angazhuar studentët në të ardhmen në grupe të punës shkencore apo referuar në konferencat shkencore të përvitshme të institucionit.</p> <p>Programet e studimeve në AU hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; Ky institucion është fokusuar qysh në fillimet e veta në drejtim të degëve të ndryshme të shkencës mjekësore.</p> <p>Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve; cka publikohet apo referohet në aktivitete shkencore.</p>

përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij dhe kryhet edhe në shërbim të marrjes së titujve e gradave shkencore.
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Ky program ka objektiva të qartë profesionale dhe është nisur nga nevoja për specialistë të kësaj fushe e konstatuar nëpërmjet takimeve, intervistave apo informacioni i atyre që kanë mbaruar studimet bachelor në këtë universitet dhe janë tashme të punësuar
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Të diplomuarit mund të punësohen në Spitale publike apo private, qendrore, rajonale e të rretheve. Mund të punësohen në klinika private, palestra fitness-i, sallone të estetikës, qendra sportive etj. Diploma e tyre u lejon atyre edhe karriere në IAL apo institucione që parashikojnë vende pune të këtij profesioni.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Duke parë prirjet e studentëve drejt arsimit profesional si dhe rritjen e kërkesave të tregut për specialist të fushës së fizioterapisë, rehabilitimit dhe për më tepër terapinë manuale, GVJ mendon se ky program studimi është një nevojë e kohës dhe tregut të punës. Kualifikimi i mëtejshëm i studentëve që tashmë kanë një diplomë bachelor do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vendin tonë.
Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Ka student aktualisht të punësuar apo vetëpunësuar akoma pa mbaruar studimet. Parashikimi i kuotave hartohet në varësi të kërkesave të tregut të punës por edhe të studentëve që përfundojnë studimet bachelor në programet e studimit fizioterapi edhe nga institucione të ngjashme. Kërkesat për këtë vit akademik kanë qenë jo të shumta cka lidhet edhe me termin terapi manuale e moskuptimin nga studentët e rëndësisë së kësaj dege profesionale. Gjithsej për këtë vit janë 17 studentë. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike merr parasysh nevojat e tregut të punës në përcaktimin e kuotave vjetore të pranimeve të reja çdo vit akademik.
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;	GVJ konstatoi se edhe për këtë program studimi, MP në Terapi Manuale, Institucioni synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare sic janë gjuha, historia, simbolet kombëtare, traditat dhe të përgatisë profesionistë të ardhshëm të cilët do të shërbejnë duke ruajtur këto vlera.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për program studimi</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Ky program studimi MP në Terapi manuale realizohet me 60 ECTS. Pra në kohëzgjatje 1 vit akademik</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për program studimi</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik, por edhe me studentët, GVJ konstatoi se studenti informohet nga pedagogu në fillim të cdo lënde apo moduli mbi përmbajtjen e syllabuseve dhe ka të drejtë të ketë një kopje të shkruar apo elektronike. Modelet e syllabuseve gjenden lehtësisht në faqen e Web-it të AU.</p>
<p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Në këtë institucon procedura e diplomimit është e përshruar në detaje në Rregulloren e Proramit të Studimit. Studentët informohen nga drejtuesit e departamentit mbi tematikat e provimit të diplomimit ku ata do të vlersohen përfundimisht. Ata njihen edhe me procedurat për të zhvilluar në kohë dhe mënyrë korekte këtë proces.</p>
<p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Ky program MP në Terapi Manuale është një program i ri në AU dhe fillon për herë të parë për vitin akademik 2018-2019.</p> <p>Duke analizuar misionin dhe qëllimin e institucionit, shprehur edhe në rregullore, marrëveshje dhe objektiva të dokumentuara del qartë, që Programi Master Profesional në "Terapi Manuale" është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka ky Universitet,</p> <p>Referuar VKM Nr.41/2018, Shtojca Nr.2, syllabuset në dosje janë ndërtuar pa mungesa në elementët përbërës. Ka një korrelim i mirë midis titujve të syllabuseve dhe përmbajtjes së tyre, si dhe përputhje e tyre me qëllimin dhe objektivat e programit studimor të propozuar. Shihet mbulim i plotë i lëndëve me pedagogë të jashtëm e të brendshëm, me tituj akademik Doktor, Prof. Asoc, dhe Prof.</p>	

MSc që janë angazhuar plotësojnë kushtin e 5 vjet me experience, gje që e kërkon standardi.

Metodat e mësimdhënies janë shprehur qartë në përputhje me specifikat e secilës lëndë. Po kështu format e vlerësimit me përqindje vlerësuese sipas formës, provim i ndërmjetëm, provim final, vlerësime detyrash (detyrime), etj. Ka një përputhje të ngarkesës në auditor dhe jashtë tij të studentit, me pritshmëritë e programit. Përmbajtja e programit është e kuptueshme dhe e përballueshme për studentët.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

GVJ mbështetur në Regulloren e Institucionit /Fakultetit konstaton, se çështjet që lidhen me organizimin e mësimdhënies, format, metodat e teknologjitë e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, vlerësimi i brendshëm, shpjegohen në këtë rregullore.

Studentët njihen qysh në fillim me këto detaje për cdo lëndë apo modul. Pjesëmarrjen në procesin mësimor, rregullat gjatë procesit mësimor, vlerësimi si kryhet etj.

Veprimtaria mësimore zhvillohet nëpërmjet leksioneve në auditor, seminareve, laboratoreve, praktikave, detyrave të kursit, projekteve. Leksionet në auditor zhvillohen jo më shumë se 25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 min.

Nga bisedat me studentë dhe personel akademik konstatuam se metodat kryesore të mësimdhënies ishin nëpërmjet slideve, shkrimit në tabelë, mësimdhënie e kombinuar nëpërmjet diskutimeve pedagog studentë etj.

Ato paraqiten si më poshtë dhe janë përshkruar edhe në RVB e institucionit për Programin MP në Terapi Manuale.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- | | |
|---|------|
| • Ndjekja e lëndës | 10% |
| • Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) | 10% |
| • Testimet gjatë vitit | 20% |
| • Provim përfundimtar | 60% |
| • Gjithsej | 100% |

- Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive janë pasqyruar në anekse Tab 14 dhe janë paraqitur edhe në rregulloret përkatëse. Ato janë ndarë sipas disa elementëve të tillë si pjesmarrja, plotsimi i detyrimeve në seminare e laboratore, testimet të ndërmjetme e përfundimtare. Cdo element zë përqindjen e vetë në vlerësimin përfundimtar.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njohurive etj

Si program i ri e që ndodhet në mes të vitit akademik, nuk ka ndonjë aktivitet posacerisht për studentet e këtij programi.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Institucioni ka përcaktuar kriteret e pranimit, vlerësuar politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit. Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;

AU për këtë aspekt është bazuar në burimet e veta njerzore dhe infrastrukturën që disponon, si dhe e ka si objektiv perfeksionimin e kriterëve të pranimit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Nëpërmjet vendimeve e rregulloreve të Institucionit studentët që pranohen në MP Terapi manuale duhet të kenë një diplomë Bachelor në përputhje me fushën e studimit si Fizioterapi, Rehabilitim etj të përafërt 180 ECTS në tre vite akademike.

Institucioni ka vendosur edhe kriteret e tjera pranimit. Për studentë që kanë kryer Bachelor në fusha të përafërta Fakulteti i Shkencave mjekësore, ka ngritur një Komision të Njohjes e Ekuivalentitmit të Programeve që bën vlerësimin e aplikantëve gjithmonë bazuar në Rregulloret përkatëse të Rregjistrimeve e Transferimeve.

Një kriter e rregull tjetër për ata që pranohen në këtë program studimi është pagesa e tarifës vjetore.

Kohezgjatje e kryerjes së studimeve është 1 vit akademik me 2 Semestra dhe afati maksimal për studentët për mbarim të programit është 2 vjet.

Forma e studimit është me kohë të plotë.

Gjatë këtij viti akademik 2018-2019 që është dhe viti i parë i fillimit të këtij programi janë regjistruar gjithësej 17 studentë me notë mesatare 6.86, të cilët do diplomohen në Korrik 2019.

Në ciklin e dytë të studimeve në programin MP, në Terapi Manuale nuk ka patur kuota për studentë të transferuar mbasi periudha e shkurtër kohore e programit nuk krijon mundësinë e transferimeve.

Nuk ka student të larguar apo transferuar sin ë semestrin e parë ashtu edhe në këtë semester në vazhdim.

Studentët e këtij programi studimi diplomohen për herë të parë në këtë vit akademik kështu që nuk jepen të dhëna për punësimin e tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët që pranohen në programin e studimit “MP” në ‘Terapi Manuale” kanë diplomën Bachelor në Fizioterapi dhe kanë fituar 180 kredite. Mund të pranohen edhe student të cilët plotësojnë këtë kriter në fusha të përafërta, por raste të tilla nuk ka patur.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Pranimi i studentëve në programin “MP” në ‘Terapi Manuale” është kryer në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra për këtë problem.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Institucioni ka përcaktuar kriteret e pranimit të institucionit për këtë program studimi. Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;	Institucioni ka vlerësuar politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, AU është bazuar në burimet e veta njerzore dhe infrastrukturën që disponon, si dhe e ka si objektiv perfeksionimin e kriterëve të pranimit.
Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	
Standardi IV.2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Informimi i studentëve bëhet nga dy Zyrat përkatëse, ajo e “Koordinimit e Mbështetjes të Studentit” dhe ajo e “Karrierës dhe Alumni”. Informohet për mundësitë e punësimit dhe ofrojnë edhe shërbimin e këshillimit duke bashkëpunuar me Këshillin Studentor.</p> <p>Javën e pare studentët orientohen dhe informohen nga Zyra e Koordinimit në orë të hapura mësimore mbi licensimin, akreditimin dhe kurrikulën e programit.</p> <p>Materialet e shtypura dhe Manuali i Studentit janë një mënyrë tjetër e informimit të studentëve</p> <p>Orientohen dhe këshillohen studentët gjatë vitit akademik sipas një rregulli të caktuar dhe njëkohësisht u jepet atyre mbështetje për krijimin e lidhjeve me komunitetin universitar dhe nëpërmjet Alumni me mundësitë egzistuese në tregun e punës. Ata pajisen me një Udhëzues për Zhvillimin e Karrierës.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>A. University disponon të dhëna të plota për cdo student në format elektronik dhe të shkruar. Ky program nuk ka ende të diplomuar.</p> <p>Nga dokumentacioni që mbahet nxirren të dhëna për studentët e regjistruar, për studentët që largohen nga programi apo ndërpresin studimet për arsye të ndryshme.</p> <p>Në sekretarinë e institucionit ka regjistër të notave, regjistër të diplomave. Po ashtu ka dhe klasifikim të dokumentacionit pra që ruhen nga momenti i pranimit deri në diplomimin e studentëve, madje një pjesë e tyre janë me ruajtje të përhershme.</p> <p>Statistikat e përvitshme të kërkuara dërgohen në MASR sipas formateve dhe afateve të përcaktuara.</p> <p>Ecuria akademike e studentëve evidentohet plotësisht, disponohen regjistrat fizikë dhe elektronikë të matrikullimit, notave dhe diplomave të studentëve të cilët plotësohen ruhen dhe arkivohen konform legjislacionit në fuqi.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet</p>	<p>Studentët që mbarojnë studimet në programe të ndryshme, janë të gjithë Alumni.</p> <p>Eshtë Zyra e Karrierës e Alumni që për të gjithë krijojnë një bazë të dhënash të punësimit të tyre pas diplomimit.</p> <p>Kjo Zyra informon studentët pas diplomimit për ofertat në tregun e punës, mundësitë e praktikave, intershipet, kualifikimet etj.</p>

e tjera të studimeve etj.	Mbi bazë të një kalendari të caktuar ka takime të here pas herëshme të Alumni me studentët në process diplomimi, për orientim të studentëve dhe paraqitje të experiences së Alumni.
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët e Universitetit informohen për të gjitha detajet e programit të studimit nëpërmjet faqes zyrtare e cila është aktive dhe përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Pedagogët kanë rolin e tyre në këtë drejtim në orët e parashikuara për tutoriatin</p> <p>AU mban të informuar në kohë reale studentëte çdo programi studimi lidhur me proceset e akreditimit, licënsimit, etj. Në grupet e vlerësimit të brendshëm gjatë procesit të akreditimit përfshihen studentë përfaqësues të këshillit studentor.</p> <p>Studentët që kur aplikojnë njihen paraprakisht me përmbajtjen e programit të studimit. Po kështu edhe për dokumentacionin e licënsimit, akreditimit, etj.</p> <p>Këto të dhëna janë publike dhe të aksesueshme nga studentët dhe publiku.</p> <p>Studentët informohen vazhdimisht për rezultatet e tyre gjatë vitit (pikët në cdo komponent të vlerësimit) si dhe me rezultatet në provimin e lëndëve dhe moduleve.</p> <p>Studentët që duan të diskutojnë rezultatet e tyre e kanë këtë mundësi me pedagogët përkatës.</p>
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Studentëve në cdo kohe kanë akses pranë personelit akademik e administrative, për cdo problem AU ndjek në vazhdimësi ecurinë e studentëve, si gjatë procesit mësimor ashtu edhe gjatë praktikave mësimore.</p> <p>Grupet e masterit janë të vogla, prandaj njihen shumë mirë nga tutorët e tyre, madje sipas tyre edhe me problematikat që mbart secili prej tyre.</p> <p>Përsa i përket praktikës profesionale institucioni i ndihmon studentët për të gjetur vendin e përshtatshëm. Kjo favorizohet edhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka Universiteti.</p> <p>Pedagogët e këtij programi njohin gjendjen reale të këtij shërbimi dhe mundësitë për pranimin e studentëve për praktika profesionale.</p> <p>Roli kryesor i Zyrës së Karrierës në AU, ne bashkëpunim me tutoret është që t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve, për zhvillimin e praktikës profesionale.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
Pranimet e studentëve në programin e studimit MP. nw Terapi Manuale bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi për IAL.	

Studentët e regjistruar informohen në mënyrë të detajuar nëpërmjet faqes zyrtare e botimeve të Universitetit për programin e studimit, kohëzgjatjen e tij, liçensimin dhe akreditimin e tij. Studentët në këtë Universitet kanë një jetë aktive studentore dhe ndihen të përfaqësuar në vendimarrje.

2 Zyrat; ajo e Koordinimit e ajo Karrierës në AU funksionojnë me eficiencë në mbështetje të studentëve. Institucioni disponon dokumentacionin përkatës për vlerësimin e dijeve të studentëve.

Gjithashtu disponohen regjistrat fizikë dhe elektronikë të matrikullimit, notave dhe diplomave të studentëve të cilët plotësohen, ruhen dhe arkivohen konform legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Politika e AU në fushën e studimit, kërkimit shkencor është komplekse, në funksion të politikës tërësore të universitetit dhe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Universiteti, për të realizuar botimet akademike në gjuhën shqipe të autorëve akademikë vendas apo të huaj, krijon dhe ve në funksionim njësinë e botimeve akademike. Revista shkencore e universitetit "OPTIME" është e njohur jo vetëm në vend, por edhe në rajon.

Albanian University është një institucion që konsideron krahas procesit mësimdhënies edhe kërkimin shkencor. Anëtarët e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë marrin pjesë në mënyrë aktive në kongrese e konferenca si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Krahas mësimdhënies e kërkimit shkencor, stafi akademik inkurajon studentët të përfshihen në projekte apo të jenë pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe workshope si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, esseve, hartimit të temave të ndryshme të bëjnë punë të pavarur. Departamenti i Infermierisë e Fizioterapisë, që mbulon edhe MP në Terapi Manuale gjatë vitit akademik 2017-2018 ka realizuar edhe Temat e para të Diplomave për programet Bachelor Fizioterapi e Infermieri, orjentim kërkimor shkencor ky dhe përgatitur nga student me mesatare të lartë e drejtuar nga pedagogët e AU.

Kërkimin shkencor në AU mbështetet nga disa laboratore të pajisur me aparatura bashkëkohore dhe me materiale cilësore për realizimin e eksperimenteve apo të metodave të reja mjekuese.

Universiteti ka një procedurë të brendshme, që realizohet në çdo fillim viti akademik e cila ka të bëjë me planifikimin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, projekte dhe prezantime të ndryshme të stafit efektiv gjatë vitit akademik.



Këtë vit stafi akademik i Fakultetit i Shkencave Mjekësore është përfshirë individualisht në disa projekte dhe kualifikime projekte të cilat janë në process dhe që janë evidentuar edhe në RVB. Në to është parashikuar pjesëmarrje aktive si të stafit akademik dhe të studentëve të programit të studimit në Fizioterapi.

AU organizon gjithashtu Konferencën e përvitshme studentore, ku këta të fundit, të udhëhequr nga pedagogët paraqesin prezantime të punimeve të tyre. Programi i Fizioterapisë është përfaqësuar çdo vit nga studentët më të mirë. Gjithashtu studentët nxiten të marrin pjesë jo vetëm në aktivitetet shkencore brenda institucionit, por edhe në ato institucione me të cilat AU ka bashkëpunim.

- Të dhëna për kërkimin shkencor gjenden në Aneksë, tabela 21

Ka aktivitet kërkimor shkencor, referime dhe botime në aktivitete shkencore kombëtare e nderkombëtare, por ato janë individuale sic edhe raportohet në RVB. Pjesmarrja në këto aktivitete me referime shkencore është e kënaqshme. *Sidoqoftë ajo që duhet të synohet është shtimi i nr. të botimeve nga kërkuesit-pedagogët në revistat e periodikët brenda e jashtë vendit, planifikimi e pjesmarrja në projekte të vetë Universitetit dhe mbështetur financiarisht nga AU.*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Edhe pse ka publikime të personelit akademik, ajo që duhet të synohet është shtimi i nr. të botimeve nga kërkuesit-pedagogët në revistat e periodikët brenda e jashtë vendit.</p> <p>Kurse pjesmarrja në aktivitete shkencore me referime shkencore është e kënaqshme.</p> <p>Studimet e kryera nga personeli akademik vlersohen për të analizuar dhe kuptuar situatën aktuale dhe zhvillimet në fushën studimore përkatëse. Stafi i AU ndihmon në formimin në vazhdim të profesionistëve të mjekësisë në të gjitha fushave. Janë organizuar aktivitete të ndryshme me pjesëmarrje të fizioterapistëve nga vendi por edhe nga vendet fqinje si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, etj. Kjo ka ndikuar në ngritjen e nivelit shkencor të profesionistëve të fushës si dhe në aplikimin e metodave të reja.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në</p>	<p>Mësimi në AU zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe por studentët shfytëzojnë literaturë bashkëkohore të huaj që i vihet nëdispozicion nga vetë institucioni.</p>

mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtëjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Nuk ka organizim të programeve specifike për kualifikim, sic edhe RVB e vë në dukje.</p> <p>Është nxitur pjesëmarrja e stafit në trajnime apo konferenca shkencore, është siguruar literatura bashkëkohore profesionale sipas kërkesave të stafit.</p> <p>Eshtë nxitur dhe sponsorizuar pjesëmarrja e stafit në kualifikime të ndryshme brenda e jashtë vendit.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Disponohen pranë Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, për cdo anëtar të stafit akademik të departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dosjet personale mepërmbajtjen e të gjithë punimeve shkencore dhe certifikatave të trajnimeve ku kanë marrë pjesë.</p> <p>AU ka një databazë të dhënash për botimet e referimet shkencore të stafit akademik të cilat rinovohen vazhdimisht për secilin anëtar.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna të pakta mbi projektet sidomos kërkimore që aktualisht janë në proces dhe individualisht merret pjesë nga personeli i këtij programi studimi, cka lidhet edhe me faktin që është program i ri.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Personeli akademik publikon punime në revista brënda dhe jashtë vendit, merr pjesë rregullisht në konferenca, seminare, kongrese brenda dhe jashtë vendit me prezantime orale, postera, etj duke synuar realizimin e objektivave personale, edukimin në vazhdimësi dhe kontribuar në zhvillimin e kërkimit shkencor të universitetit dhe mjekësisë në përgjithësi.</p> <p>Institucioni nxit dhe përkrah edhe financiarisht cdo projekt të vlefshëm që ndërmerret nga stafi dhe studentët.</p> <p>Cdo anëtar i departamentit disponon dosjen personale me përmbajtjen e të gjithë punimeve shkencore dhe certifikatave të trajnimeve ku kanë marrë pjesë.</p> <p><i>Në të ardhmen duhet synuar në shtimin e botimeve në revista e periodikë dhe mundësinë e projekteve të vetë AU dhe Departamentit Infermieri Fizioterapi.</i></p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

AU dhe Fakulteti I Shkencave Mjekësore si pjesë e tij kanë nënshkruar marrveshje me institucione kombëtare si ISHP (Instituti I Shëndetit Publik) dhe ndërkombëtare sidomos në ITALI me Universitetet e Pisës, të Napolit, e Aquilas.

Nëpërmjet këtyre marrveshjeve synohet të garantohet shkëmbimi i stafit akademik dhe mundësimi i projekteve të tjera të përbashkëta cka do cojë më tej zhvillimin cilësor të arsimit të lartë të këtij Fakulteti dhe ndërkombëtarizimin e tij.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i Lekcioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

Në vitet e mënyshme të shërbimit në Departamentin të Infermierisë e Fizioterapise, ka synuar marrveshje me institucione të tjera brenda vendit, që konsiderohen të linjes si IAL publik, apo edhe me subjekte private, cka e bejne të mundur realizimin e programit. Ka dhe një strategji për avancimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit për rritjen e cilësise mesimdhënies e sidomos të praktikës profesionale.

Në përgjithësi këto institucione funksionojnë në një spektër më të gjerë (fizioterapi dhe rehabilitim) dhe nuk janë institucione që veprojnë specifikisht në fushën e terapise manuale.

Të tilla institucione mund të përmenden ndër vite:

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese:	Lloji i bashkëpunimit
Institucioni 1: Q.S.U.T	Bashkëpunim për realizimin e praktikave profesionale
Klinika e Fizioterapise 'Kiropraktik '	Realizimi i praktikave Profesionale
Klinika e Fizioterapise 'Primavera '	Realizimi i Praktikave Profesionale
Shoqata e Rehabilitimit Fizik	Realizimi i Praktikave Profesionale
Klinika e Fizioterapisë 'Balance '	Realizimi i Praktikave Profesionale
Klinika e Fizioterapisë 'RED '	Realizimi i Praktikave Profesionale
Agjencia e Shërbimit te Sportit '	Realizimi i Praktikave Profesionale
Institucioni 2: Spitali rajonal Berat Spitali Rajonal Fier	Bashkëpunim për realizimin e praktikave profesionale

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve, institucioni ka patur dhe ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione serioze që operojnë në këtë fushë si: Q.S.U.T, Agjencia e Shërbimit te Sportit ', Shoqata e Rehabilitimit Fizik, Klinikat e Fizioterapisë, Balance, Red, Primavera etj. Në përgjithësi këto institucione funksionojnë në një spektër më të gjerë (fizioterapi dhe rehabilitim) dhe nuk janë institucione që veprojnë specifiku në fushën e terapise manuale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie</p>	<p>GVJ u informua si nga drejtuesit edhe stafi se ekziston një komunikim i hapur i stafit akademik si dhe personelit administrativ të Universitetit. Kjo mënyrë komunikimi ndihmon në identifikimin në kohë të problemeve të ndryshme, që mund të lindin si dhe në lehtësimin në vendimmarrje për zgjidhjen e tyre</p> <p>Bashkëpunimi ndërmjet zyrave dhe personave të</p>

të frytshme bashkëpunimi.	interesit konsiderohej një përparësi e domosdoshmëri ne AU dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Ky bashkëpunim realizohej nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm. Personat e punësuar kanë të mirëcakturara detyrimet dhe të drejtat dhe janë përgjegjës për punën e kryer.
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>AU dhe Fakulteti I Shkencave Mjekësore si pjesë e tij kanë nënshkruar marrëveshje me institucione kombëtare si ISHP (Instituti I Shëndetit Publik) dhe nderkombëtare sidomos në ITALI me Universitetet e Pisës, të Napolit, e Aquilas.</p> <p>Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve, institucioni ka patur dhe ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione serioze që operojnë në këtë fushë si: Q.S.U.T, Agjencia e Shërbimit të Sportit ‘, Shoqata e Rehabilitimit Fizik, Klinikat e Fiziotherapisë; Balance, Red, Primavera etj.</p> <p>Institucioni organizon trajnime të ndryshme për stafin, dhe pse ka nevojë për përmirësim.</p> <p>AU bën një raport të detajuar në përfundim të cdo viti akademik mbi projektet e marrëveshjeve dhe programeve të studimit që ai ofron.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p> <p>Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë seriozë homologë vendas apo të huaj, publik apo privat për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</p> <p>Në përgjithësi këto institucione funksionojnë në një spektër më të gjerë (fizioterapi dhe rehabilitim) dhe nuk janë institucione që veprojnë specifikisht në fushën e terapise manuale.</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Mjedis optimal për zhvillimin e mësimi (leksione, seminare), si për pedagogët edhe për studentët.
- 2) Departamenti i Infermierisë e Fizioterapisë ka krijuar tani fizionomie e vet dhe eksperiencën e duhur për të zhvilluar e përmirësuar më tej më tej programet e kësaj fushe.
- 3) Lidhja me Universitetet Italiane ndihmon në saj të shkëmbimit të përvojës dhe kualifikimit personelit akademik për rritjen e cilësisë së këtij IAL

b. Pika të dobëta:

- 1) Evidentohet vështirësia në rekrutimin e stafit specifikisht për këtë program, për arsye të mungesës së pedagogëve me grada/tituj kryesisht në fushën e fizioterapisë e rehabilitimit e për më tepër në terapi manuale në nivel kombëtar.
- 2) Mjedis i pamjaftueshem për zhvillimin e mësimi praktik për studentët e këtij programi studimi.

c. Mundësitë:

- 1) Kualifikimi i stafit aktual ne kuadër të bashkëpunimeve. Shkolla italiane është e njohur në fushën e Terapisë Manuale.
- 2) Pedagogë të ftuar nga Universitete të huaj (Itali) që operojnë specifikisht në fushën e Terapisë Manuale
- 3) Në një të ardhme të shikohet mundësia e zgjatjes së kohës së realizimit të një programi MP në Terapi Manuale (2 vjet psh.). Kjo e lidhur me vetë natyrën specifike të terapisë manuale dhe sidomos nevojës për praktika për të siguruar aftësimin e të diplomuarve në manipulimet manuale..
- 4) Përmirësimi i kurrikulës në pershtatje me shkollat e terapisë manuale
- 5) Krijimi i një kabineti fizioterapie të përshtatshem për terapi manuale, 2 student 1 shtrat dhe mundësisht elektrik.
- 6) Kryerja e praktikave kryesisht në ambientet ku ofrohët programi i studimit ose në qendra rehabilitimi ku ofrohet terapi manuale e mirëfillte, jo kineziterapi tradicionale apo neurorehabilitim.
- 7) Organizimi i konferencave për terapinë manuale me të ftuar me ekperience në fushë.

d. Pengesat:

- 1) Mungesa e pedagogëve me grada/e tituj në këtë fushë
- 2) Mungesa e përvojës në terapi manuale të mirëfilltë në institucionet e vendit tonë që ofrojnë shërbim Rehabilitues

e. Rekomandime

- 1) Kualifikimi i stafit aktual në kuadër të bashkëpunimeve në fushën e Terapisë Manuale nga pedagogë të ftuar nga Universitete të huaj (Itali) që operojnë specifikisht në fushën e Terapisë Manuale.
- 2) Të shikohet mundësia e zgjatjes së kohës së realizimit të një programi MP në Terapi Manuale (2 vjet psh.) e lidhur me nevojën për praktika për të siguruar aftësimin e të diplomuarve në manipulimet manuale.
- 3) Përmirësimi i kurrikulës në përshtatje me IAL (jashtë vendit), që ofrojnë programe të terapisë manuale
- 4) Vënja në funksion të një kabineti të përshtatshëm për terapi manuale, 2 student 1 shtrat dhe mundësisht elektrik.
- 5) Të synohet, që studenti gjatë praktikave të fokusohet në terapi manuale të mirëfillte, jo kineziterapi tradicionale apo neurorehabilitim.
- 6) Organizimi i sesioneve shkencore apo konferencave për terapinë manuale me të ftuar me ekperience në fushë.



SUMMARY ANALYSIS ON THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM

Summary analysis of the RVJ compliant to SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

a. Strengths:

- 1) Optimal environment for lesson delivery (lectures, seminars), both for lecturers and students.
- 2) The Department of Nursing and Physiotherapy has now created its own physiognomy and experience towards further development and improvement of the study programs of this specific field.
- 3) The partnership with Italian Universities helps in the exchange of experience and qualification of the academic staff leading to quality enhancement of this HEI.

b. Weaknesses:

- 1) There is a difficulty in recruiting staff specifically for this study program, due to the lack of lecturers with scientific grades or titles mainly in the field of physiotherapy and rehabilitation and specifically in manual therapy at a national level.
- 2) Insufficient premises for the delivery of practical classes for students of this study program.

c. Opportunities:

- 1) Qualification of current staff within the framework of collaborations. The Italian School is well-known in the field of manual therapy.
- 2) Guest lecturers from the foreign universities (Italy) operating specifically in the field of manual therapy
- 3) In the future, it should be considered the possibility to expand the study period of PM program on Manual Therapy (2 years). This is related to the specific nature of manual therapy and especially the need for practices in order to build up graduates' skills in manual therapy.
- 4) Improving the curriculum to fit with manual therapy schools.
- 5) Setting up a physiotherapy room suitable for manual therapy, 2 students 1 bed, preferably an electric one.
- 6) Carrying out the practical classes mainly in the premises where the study program is provided or in rehabilitation centers where manual therapy is provided, not traditional kinesiotherapy or neurorehabilitation.
- 7) The organization of conferences on manual therapy with experienced guest speakers and experts of this field.



d. Threats:

- 1) Lack of lecturers with scientific grades or titles in this field
- 2) Lack of experience in Manual Therapy in Albanian rehabilitation institutions.

e. Recommendations

- 1) Qualification of current staff, in the framework of collaborations in the field of Manual Therapy, by guest lecturers from foreign universities (Italy) operating specifically in the field of Manual Therapy.
- 2) Considering the possibility to expand the study period of PM program on Manual Therapy (2 years). This is related to the specific nature of manual therapy and especially the need for practices to train graduates in manual therapy.
- 3) Improving the curriculum in line with HEI (abroad) which provide manual therapy programs.
- 4) Setting up a suitable room for manual therapy, 2 students 1 bed, preferably an electric one.
- 5) Aiming to focus students' practical classes on manual therapy, not traditional kinesiotherapy or neurorehabilitation.
- 6) Organizing scientific/research sessions or conferences on manual therapy with experienced guest speakers and experts of this field.

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha

Dr. Enkeleda Sinaj

